



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:130074

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453162

P.nr.139/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili, me bashkëpunëtoresh profesionale Liridona Musliu Bekteshi, në çështjen penale kundër të pandehurit: A.P. për shkak të veprës penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2162/23, të datës 07.05.2024, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.1460/24, të datës 30.10.2024, të lidhur në mes të pandehurit A.P. dhe të dëmtuarës D.-A.. me përfaqësues S.D., jashtë seancës, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje si: KPP) dhe nenit 2 paragrafi 2, nenit 8 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), me datë 14.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.1460/24, të datës 30.10.2024 e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mes palëve: të pandehurit A.P. dhe të dëmtuarës D...-A....
2. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2162/23, të datës 07.05.2024 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: A... P... nga i ati A..., e ëma F..., i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin ..., Vushtrri, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.
3. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.2162/23, të datës 07.05.2024 kundër të pandehurit A.P. për shkak të veprës penale: Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Me datën 30.10.2024 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.1460/24, të datës 24.10.2024 në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit A.P. dhe të dëmtuarës dëmtuarës D...-A... Mitrovicë.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 paragrafi 2 dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit.

Bazuar në nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 05.11.2024 do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës së ndërmjetësimit, siç konstatohet në marrëveshjen e ndërmjetësimit do t'i bartë i pandehuri A.P.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.139/24, datë 14.11.2024

Gjyqtarja

\_\_\_\_\_

Dardane Ismaili

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tri (3) ditësh nga pranimi i tij, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.